



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
PRISHTINË - PRISHTINA

KOLEGJI “PJETËR BUDI” – PRISHTINË
PROGRAMI: DOGANË DHE SHPEDICION

TEMA BAÇELOR

INSTITUCIONET JURIDIKE DOGANORE
TË NJË SHTETI

Mentorja:
Prof. Fiknete Bejta

Studenti:
Fabio Saraçi

Prishtinë, 2025



DEKLARATA E STUDENTIT

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është punuar nga unë, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar në tërësi ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Emri dhe mbiemri

Fabio Saraci



PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	4
2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	5
3. TERRITORI DOGANOR	5
3.1. Unioni Doganor	6
3.2. Zonat e lira doganore	7
3.3. Shitoret e lira doganore	8
4. LINJA/VIJA DOGANORE	9
5. BREZI KUFITAR DOGANOR	10
6. VENDKALIMET KUFITARE DOGANORE	11
6.1. Vendkalimi kufitar për qarkullim ndërkuftar	12
7. QARKULLIMI KUFITAR DOGANORE	13
7.1. Qarkullimi i pronësisë së dyfishtë.....	13
7.2. Qarkullimi i vogël kufitar.....	13
8. ZONA E KONTROLLUAR DOGANORE	14
9. MBIKËQYRJA DOGANORE	14
10. Llojet e mbikëqyrjes doganore.....	17
10.1. Sipas drejtimit të lëvizjes së mallrave doganore.....	17
10.2. Sipas prezencës së mallrave doganore	18
10.3. Sipas llojit të trafikut dhe të mjeteve transportuese.....	19
10.4. Sipas mënyrës së identifikimit dhe evidentimit të mallrave doganore.....	19
10.5. Sipas sendit konkret dhe kohës së mbikëqyrjes doganore dallojmë:	19
11. MALLRAT DOGANORE.....	21
12. KARAKTERISTIKAT E MALLIT DOGANOR	22
13. KONKLuzionET.....	24
14. PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET	25
15. LITERATURA E SHFRYTËZUAR	27



1. HYRJE

Ky punim koncentrohet në temën “**Institucionet Juridike Doganore të një Shteti**” dhe ka për qëllim të shtjelloj po thuajse të gjitha Institucionet juridike doganore të një shteti.

Një shtet i pavarur duhet të ketë kufinjë e po ashtu edhe ligje të brendshme jo vetëm për mbrojtjen e këtyre kufijve, por edhe për mbrojtjen e ekonomisë së brendshme, evazionit fiskal, uljen e korrupsionit, trajtimin e duhur të mallrave si në eksport ashtu edhe në import dhe të tjera.

Këto janë pikërisht disa prej arsyeve se pse është e nevojshme të studiohet kjo temë dhe të jetë e njohur për të gjithë qytetarët e një shteti.

Në mënyrë që një shtet t’i përmbahet ligjeve dhe t’i zbatoj ato në mënyrën më efikase të mundshme, është e domosdoshme të qëndroj mirë ekonomikisht e politikisht si dhe të ketë ekspertë të lamive përkatëse në mënyrë që të instalohet dhe punohet me teknologji dhe sisteme të avancuara.

Një ndër faktorët kryesor për mbrojtjen e ekonomisë së një shteti është Dogana e atij shteti e cila me anë të taksave dhe institucioneve të saj të ndryshme mbron ekonominë e vendit. Dogana e një shteti të qëndrueshëm jep beneficione dhe lirime nga taskat për investitorët e huaj në mënyrë që të ketë një zhvillim të hovshëm ekonomik si dhe ulje të papunësisë në atë shtet.



2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Metodologjia ime për temën e diplomës do të jetë e bazuar në analiza të dokumentave të institucioneve juridike doganore të shtetit. Do të kryej intervista me ekspertët e fushës dhe do të analizoj raste të ndryshme që kanë ndodhur në fushën doganore.

3. TERRITORI DOGANOR

Territori doganor është institucioni kryesor doganor, baza dhe premisa e institucioneve të tjera doganore. Pa ekzistimin e territorit doganor nuk mund të zbatohen institucionet e tjera juridike doganore. Territori doganor është hapësira territoriale shtetërore, ku aplikohen dhe gjejnë zbatim dispozitat juridike për institucionet juridike doganore, instrumentet dhe politikat doganore të një shteti të pavarur. “Me rajon doganor të një shteti nënkuptohet territori, në të cilin zbatohet sovraniteti doganor i atij shteti, i shprehur përmes së drejtës doganore nacionale, e cila paraqet përmbledhje të normave juridike të pranura kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht.”¹

Natyrisht se për nocionin territor doganor përdoren edhe emërtime tjera si: *rajon doganor dhe/apo hapësirë doganore*. Territori doganor zakonisht përkufizohet me ligjin për dogana të një shteti.

Kësisoj duke iu referuar Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, përkatësisht neni 3 paragrafi 1 dhe 2, territori doganor përcaktohet kësisoj:

1. Legjislacioni doganor i Republikës së Kosovës do të zbatohet në mënyrë unike në tërë Kosovën.
2. Dispozitat e caktuara të legjislacionit doganor të Republikës së Kosovës, po ashtu mund të zbatohen jashtë Kosovës përbrenda kornizës ligjore që rregullon fushat e veçanta ose të konventave ndërkombëtare.

¹ Pjetër Budi - “E Drejta Doganore”, Prishtinë, 2013,



Nga përkufizimi i ligjit nënkuptohet se territori doganor përfshinë tërë hapësirën territoriale të Republikës së Kosovës. Në hapësirën territoriale të Republikës së Kosovës hyjnë: **hapësira tokësore, ujore, dhe ajrore**, pra përfshinë territorin që konform të drejtës ndërkombëtare konsiderohet territor shtetëror i një shteti sovran, në rastin konkret të Republikës së Kosovës. Pjesa tokësore, si territor i rajonit doganor të Republikës së Kosovës e përfshinë tërë pjesën e thatë tokësore së bashku me resurset ujore në të, deri në qendrën e rruzullit tokësor.

Sipërfaqja ujore, si territor i rajonit doganor i përfshinë sipërfaqet ujore deri në kufijtë me shtetet fqinje, gjatë së cilës kufiri në liqene është i rregulluar me ligj në pajtim me shtetet fqinje. Sipërfaqja ajrore, si territor i rajonit doganor e paraqet hapësirën ajrore dhe jo ajrore mbi sipërfaqen tokësore dhe ujore, në mënyrë të pakufizuar në pikëpamje vertikale.

Territori doganor parimisht është identik me territorin shtetëror edhe pse në rregullat e përgjithshme ekzistojnë përjashtime. Ka raste kur territori doganor është më i madh se territori shtetëror, këto janë raste të bashkëngjitjes doganore dhe përjashtimit doganor.

Këto dy institute juridike janë në korrelacion njëra me tjetrën. Kur kemi përjashtim doganor për një shtet, për tjetrin kemi bashkëngjitje dhe e kundërta. Në praktikë ekzistojnë disa raste të mospërputhjes së territorit shtetëror me territorin doganor.

3.1. Unioni Doganor

Unioni doganor është bashkim ekonomik doganor që bëhet me marrëveshje apo kontratë ndërkombëtare ndërshtetërore për liberalizimin e tregtisë dhe për eliminimin e barrierave doganor në mes të shteteve pjesëmarrëse, nënshkruese të kësaj marrëveshje.² Kjo do të thotë se shtetet anëtare të unionit doganor e bartin një pjesë të sovranitetit shtetëror tregtar tek unioni apo bashkimi i shteteve. Karakteristikë e unionit doganor është se shtetet anëtare i eliminojnë taksat dhe pengesat tjera doganore, ndërsa për shtetet e treta aplikojnë tarifë të njëjte. Në këto raste territori doganor është më i madh se territori shtetëror i një shteti, sepse përfshin territorin shtetëror të të gjithë anëtarëve të Unionit. Shembull më i mirë i Unionit doganor është Unionin Evropian, në të cilin funksionon edhe tregu i përbashkët si integrim ekonomik më i madh se

² Pjeter Budi - "E Drejta Doganore", Prishtinë, 2013,



unioni doganor. Komuniteti Evropian është një bashkim doganor, përderisa midis Shteteve Anëtare sigurohet qarkullimi i lirë i mallrave. Kjo i detyron ato të heqin taksat doganore ose taksat me efekt të njëjtë, si dhe të gjitha masat me natyrë kufizimesh sasiore. Përveç të tjerash, në kufijtë e jashtëm të Komunitetit Evropian është vendosur një tarifë doganore e përbashkët. Ky bashkim doganor si dhe tarifa doganore e përbashkët përbëjnë tregun e përbashkët, i quajtur gjithashtu tregu i brendshëm.

3.2. Zonat e lira doganore

Rast tjetër i mos përputhjes së territorit shtetëror me territorin doganor, kemi ekzistimin e të ashtuquajturave Zona të Lira Doganore. Zonat e lira doganore themelohen brenda hapësirës territoriale dhe gjeografike shtetërore të një shteti, por në këto zona nuk zbatohet sovraniteti doganor i shtetit, në të cilin është krijuar zona e lirë doganore. Meqenëse territori i zonave të lira doganore paraqet përjashtim nga territori shtetëror i një vendi sovran, brenda tyre nuk zbatohet pushteti legjislativ, ekzekutiv apo gjyqësor i shtetit me vullnetin e të cilit është themeluar zona e lirë doganore.

Në esencë ato shprehin eksterritor në raport me territorin e vendit, i cili i ka themeluar ato zona të lira doganore.³ Në zonat e lira doganore nuk aplikohen taksat doganore ndaj mallrave të huaja të vendosura në këto zona. Mallrat e huaja konsiderohen të barabarta me mallrat vendore, dhe ndaj tyre aplikohen masat e mbikëqyrjes doganore para largimit nga zona e lirë doganore, dhe vendosjes në qarkullin në territorin doganor, ku është vendosur zona e lirë doganore.

Edhe Kodi Doganor i Republikës së Kosovës ka paraparë mundësinë e themelimit të zonave të lira doganore. Duke iu referuar nenit 166, ky kod përcakton: 1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në konsultim me Doganat, mund të caktojë pjesë të Kosovës, si zona të lira apo të autorizojë themelimin e depove të lira. 2. Qeveria e Republikës së Kosovës, në konsultim me Doganën, përcakton sipërfaqen e mbuluar në secilën zonë. Ambienti për tu përcaktuar si depo e lirë, duhet të aprovohet nga Dogana. 3.

³ “Bazat e Sistemi Doganor”, Prishtinë, tetor 2010, fq. 38, 39.



Zonat e lira, me përjashtim të atyre të përcaktuara me nenin 168, do të rrethohen. Dogana përcakton pikat e hyrjes dhe të daljes për çdo zonë të lirë apo depo të lirë. 4. Ndërtimi i çfarëdo ndërtese në zonë të lirë, kërkon aprovim paraprak të Doganës.

3.3. Shitoret e lira doganore

Shitoret e lira doganore janë rasti i tretë i mospërputhjes së territorit shtetëror me territorin doganor. Shitoret e lira doganore formohen në zonat e qarkullimit ndërkombëtar të udhëtarëve ekskluzivisht në aeroporte dhe porte detare. Në shitoret e lira doganore mundësohet shitja e mallrave pa iu nënshtruar detyrimeve doganore për udhëtarët, të cilët e lëshojnë shtetin e tyre.

Baza juridike e organizimit të shitoreve të lira doganore ekziston në rekomandimet e Këshillit për Bashkëpunim Doganor në Bruksel të datës 16 qershor 1960. Sipas Rekomandimeve të këtij Këshilli, shitoret e lira doganore mund të hapen në portet detare dhe aeroportet e hapura për qarkullim ndërkombëtar të udhëtarëve. Përpos kësaj, po sipas këtyre rekomandimeve, malli në shitoret e lira doganore mund t'u shitet vetëm udhëtarëve, të cilët udhëtojnë në botën e jashtme në komunikacionin ajror dhe ujor.⁴ Për hapjen e shitoreve të lira doganore duhet të merret leja nga organet kompetente.

Procedura për themelimin dhe operimin e tyre në territorin doganor të një shteti parashihet me ligjin për doganat, ose me ligjin për drejtorinë doganore varësisht si e rregullon këtë sferë shteti përkatës. Zonat Eksterritoriale Duke u bazuar në të drejtën ndërkombëtare dhe mirësjelljen diplomatike që është krijuar ndër shekuj, ekziston e ashtuquajtura zona eksterritoriale. Fjala është për përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të akredituara në një shtet të pavarur dhe sovran. Këto zona dhe zyrtarët, të cilët janë të angazhuar me punë në këto institucione, si ambasadorët, personeli tjetër i ambasadave dhe konsullatave, gëzojnë imunitete dhe privilegje të theksuara.

Këto privilegje parashihen me të drejtën zakonore ndërkombëtare, por janë rregulluar edhe me Konventa. Kështu në vargun e shumë privilegjeve që gëzojnë këto institucione, janë edhe imunitetet në lëmin e taksave dhe lirimeve doganore. Sipas Konventës së Vjenës për Imunitetet



dhe Privilegjet e Përfaqësuesve Diplomatik, shteti i pranimit duhet të lejoj hyrjen apo importimin e të gjitha sendeve për nevoja zyrtare ose për nevoja personale të agjentëve diplomatik. Artikujt e tillë janë të përjashtuar nga çfarëdo doganimi, çfarëdo takse ose çfarëdo kërkesë tjetër që mund të bëhet.

Në vendet ku janë të vendosura përfaqësitë diplomatike dhe konsullore nuk aplikohet legjislacioni i shtetit të pranimit, për këtë flitet si oaza juridike në një shtet dhe mbi këtë bazë edhe janë quajtur eksterritore. Për arsye të tillë edhe legjislacioni doganor nuk aplikohet në këto zona apo vende. Karakteristikë e sendeve që importohen për nevoja zyrtare dhe personale të stafit të këtyre institucioneve është se nuk lejohet shitja e tyre.

4. LINJA/VIJA DOGANORE

Linja doganore, ndryshe quhet edhe vija doganore apo kufiri doganor, është një tjetër institucion i rëndësishëm i të drejtës doganore. Linja doganore definohet me ligj, kështu sipas Ligji për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror: “Vija kufitare” nënkupton vijën, e cila ndanë territorin e Republikës së Kosovës nga territoret e shteteve fqinje, ndërsa “Kufiri shtetëror” nënkupton kufirin tokësor, ujor, dhe ajror përfshirë aeroportet, të cilat zhvillojnë komunikacion ndërkombëtar.”⁵ Esenca e kufirit shtetëror është se, me të shënohet hapësira në të cilën shtrihet sovraniteti juridiko-politik i çdo shteti. Me kalimin e vijës doganore fillon të vlejë e drejta e shtetit të rajonit doganor, në të cilën ka kaluar malli. Kalimi i vijës doganore e përcakton edhe vlerën kohore të së drejtës doganore. Kjo nënkupton se në momentin e kalimit të mallit në vijën kufitare, zbatohen dispozitat doganore- juridike, të cilat janë të vlefshme në çastin e kalimit të vijës doganore.

Linja doganore parimisht është identike me kufirin shtetëror. Mirëpo ekzistojnë raste dhe situata me të cilat nuk përputhet linja doganore me kufirin shtetëror, këto janë ato rastet e përmendura të territori doganor, ekzistimi i përjashtimeve doganore dhe bashkëngjitjes doganore. Me kalimin e linjës doganore, një mall i caktuar e fiton statusin e mallit doganor dhe

⁵ Kolegji Pjetër Budi - “E Drejta Doganore”, Prishtinë, 2013,



mbi të aplikohen dispozitat juridike, apo sovraniteti doganor i një shteti dhe fillon procedura e caktuar doganore ndaj atij malli. Për këtë arsye edhe është shumë më rëndësi të përcaktohet saktësisht me dispozita pozitive linja doganore. Kalimi i linjës doganore përcakton edhe përfundimin e një sovraniteti doganor dhe fillimin e zbatimit të sovranitetit doganor të një shteti tjetër.

5. BREZI KUFITAR DOGANOR

Brezi kufitar doganor është pjesë e hapësirës territoriale të një shteti e më këtë edhe të territorit doganor, në të cilën vlejnë masat e shtuara të mbikëqyrjes doganore. Brezi kufitar doganor është pjesë e territorit doganor prej vijës doganore për në brendi të vendit, gjerësinë dhe sipërfaqen e të cilit e cakton me ligj, në mënyrë autonome, secili shtet sovran. Sipërfaqja dhe gjerësia e brezit kufitar doganor, para se gjithash, varet nga interesat ekonomike, politike dhe të sigurisë.⁶

Brezi kufitar doganor është hapësira territoriale nga linja doganore për në thellësi të territorit doganor, në të cilën aplikohen masat e shtuara të mbikëqyrjes doganore, dhe rëndom në këtë hapësirë territoriale vlejnë rregulla të kufizuara për ushtrimin e veprimtarive biznesore, afariste, organet doganore ushtrojnë kontroll të shtuar ndaj personave dhe mallrave që hyjnë apo dalin në brezin kufitar doganor.

Madhësia e kësaj hapësirë të territorit doganor, që quhet brez kufitar doganor, përcaktohet me dispozita juridike. Për shembull: Nocioni dhe përmbajtja e brezit kufitar doganor në Republikën e Maqedonisë është e përcaktuar me Ligjin për Drejtorinë doganore. Sipas tij: “Brezi kufitar doganor në tokë është pjesë e rajonit doganor të Republikës së Maqedonisë, në gjerësi prej 15 km nga vija doganore në brendinë e territorit të Republikës së Maqedonisë”. Brezi kufitar doganor mund të jetë brez kufitar doganor tokësor dhe ujor.

Brezi kufitar doganor tokësor është pjesë e territorit doganor të një shteti që shtrihet nga linja doganore tokësore për në thellësi të territorit doganor tokësor, gjatësia dhe gjerësia e të cilit përcaktohet me ligj. Brezi kufitar doganor ujor mund të jetë: brez kufitar doganor liqenor, i

⁶ “Bazat e Sistemi Doganor”, Prishtinë, tetor 2010, fq.. 40



lumenjve dhe detar. Ashtu siç kemi përmendur me lart, hapësira e territorit doganor dhe shtetëror që konsiderohet brez kufitar doganor caktohet me ligj, edhe kur është fjala për brezin kufitar doganor në detra, liqene dhe lumenj, shteti me ligj e cakton një pjesë të territorit që kalon nëpër ujëra si brez kufitar doganor.

Në Republikën e Kosovës deri në momentin e shkrimit të këtij teksti nuk kam hasur në dispozitë juridike që e përcakton brezin kufitar doganor, përveç asaj që në praktikë në vendet e caktuara kufitare shkruan tabela treguese “Zonë doganore”.

Mendojmë se ky institut juridik doganor duhet të rregullohet me ligj, dhe të përfshihet në Ligjin për Drejtorinë Doganore, i cili mungon në shtetin tonë.

6. VENDKALIMET KUFITARE DOGANORE

Vendkalimet kufitare doganore apo rrugët doganore, janë vende zyrtare të përcaktuara me akt pozitiv – juridik - me ligj nga secili shtet, përmes të cilave realizohet qarkullimi ndërkombëtar i mallrave, shërbimeve dhe udhëtarëve prej njërit në territorin tjetër doganor dhe shtetëror, përmes komunikacionit tokësor (rrugor dhe hekurudhor Vendkalimi kufitar doganor është vend i caktuar me ligj dhe marrëveshje ndërshtetërore, i cili përmban objekte të ndërtuara, infrastrukturë dhe pajisje për punë të organeve shtetërore (policia kufitare dhe administrata doganore) dhe shoqatave tregtare (agjencionet doganore apo shpeditere, kompanitë e sigurimeve, etj.), të cilat ushtrojnë veprimtari nga fushëveprimi i tyre në vendkalimin e caktuar kufitar (rrjeti rrugor, organet inspektuese, postën, këmbimoren, free shop etj).

Sipas Ligji për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror, Ligji Nr. 03/L-065 “Pikat e kalimit kufitar” nënkupton vendet e identifikuar zyrtarisht, ku personat, mallrat dhe pasuritë e tundshme mund të kalojnë kufirin në mënyrë legjitime gjatë orarit të punës. “Kufiri i gjelbër” nënkupton çdo vijë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera me përjashtim të pikave zyrtare të kalimit. “Kufiri i Kaltër” nënkupton çdo hapësirë me ujë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera me përjashtim të pikave zyrtare të kalimit.

“Kalimi i kufirit shtetëror” nënkupton të gjitha lëvizjet e njerëzve, mallrave dhe pasurive të tundshme matanë kufirit shtetëror. Bazuar në këtë ligj pikat e kalimit kufitar caktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës.



Mirëpo vlen të përmendet fakti se për caktimin i pikave të qarkullimit kufitar, është e domosdoshme marrëveshja ndërshtetërore me vendet fqinjë që gjeografikisht gjenden ose kufizohen me shtetin përkatës. Pa marrëveshje ndërshtetërore nuk është i mundur qarkullimi ndërkombëtar i mallrave, shërbimeve dhe udhëtarëve pa marrë parasysh llojin e ambientit qarkullues, tokësor, ajror apo ujor. Distanca e pikave të qarkullimit kufitar në mes të shteteve tek qarkullimi tokësor dhe lumor, është e vogël, ndërsa tek qarkullimi detar dhe ajror, është shumë më e madhe.

Në teorinë e së drejtës dhe sistemi doganor, por edhe shikuar nga praktika e përgjithshme, vendkalimet kufitare doganore ndahen në: 1. vendkalimet kufitare për qarkullim ndërkombëtar dhe 2. vendkalimet kufitare ndërkufitare. Neni 2 paragrafet 6, 7, 8 dhe 9 i Ligjit për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror, Ligji Nr. 03/L-065 75 5.1. Vendkalimi kufitar për komunikacion ndërkombëtar Vendkalimi kufitar për komunikacion ndërkombëtar, është vendi përmes të cilit shtetasit e Republikës së Kosovës, nga rajoni i caktuar i Republikës dhe shtetasit e rajonit të caktuar të shtetit fqinjë, e kalojnë kufirin shtetërorë në bazë të marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare.

Të këtij lloji janë shumica e vendkalimeve kufitare, që realizohen nga praktika e përditshme juridike dhe doganore.

6.1. Vendkalimi kufitar për qarkullim ndërkufitar

Në disa shtete ekzistojnë edhe Vendkalimet kufitare për trafikun ndërkufitar. Të drejtë kalimi nëpër këto rrugë doganore kanë vetëm një kategori e caktuar e personave. Këtë të drejtë ata e realizojnë në bazë të marrëveshjes bilaterale ndërkombëtare. Këta janë kryesisht personat, të cilët kanë pasuri të patundshme në vendet fqinje dhe për lehtësimin e qarkullimit të tyre, nënshkruhen marrëveshje ndërshtetërore. Për dallim prej vendkalimeve ndërkombëtare kufitare, këto dallojnë edhe sipas orarit të punës dhe zakonisht janë të hapura vetëm gjatë ditës dhe gjatë periudhave të caktuara sezonale vjetore, si p.sh. gjatë sezonës së verës për punimin e tokës etj.



7. QARKULLIMI KUFITAR DOGANORE

Qarkullimi kufitar doganor është në korrelacion të ngushtë me vendkalimet kufitare doganore. Për qarkullimin kufitar të mallrave, shërbimeve dhe njerëzve hapen vendkalimet kufitare zyrtare doganore. Qarkullim kufitar doganor nënkuptojnë lëvizjen faktike dhe ligjore të mallrave, shërbimeve, dhe të njerëzve prej një territori doganor në territorin tjetër doganor. Qarkullimi kufitar doganor mund të jetë në formë: 1. qarkullimi i pronësisë së dyfishtë dhe 2. qarkullimi i vogël kufitar.⁷

7.1. *Qarkullimi i pronësisë së dyfishtë*

Qarkullimi i pronësisë së dyfishtë ka të bëjë me qarkullimin me mallra, i cili kryhet në kuadër të hapësirës doganore nga ana e personave me pronësi të dyfishtë. Dypronësorët janë persona, të cilët kanë shtetësi dhe vendbanim në njërin shtet, kurse kanë pasuri në shtetin tjetër (pa marrë parasysh se a është e ndarë prona me vijën doganore ose krejtësisht është në shtetin tjetër).⁸

7.2. *Qarkullimi i vogël kufitar*

Qarkullimi i vogël kufitar paraqet qarkullim të mallrave dhe shërbimeve që realizohet brenda hapësirës kufitare nga ana e subjekteve që kanë seli apo njësi organizative në hapësirën kufitare. Me marrëveshjet ndërshtetërore për qarkullim të vogël kufitar zakonisht rregullohen këto çështje: Përparësitë për lëvizjen e qytetarëve, të cilët janë të punësuar në një shtet, kurse jetojnë në shtetin fqinj; Përparësitë për bartjen e prodhimeve të destinuara për qëllime personale të personave, të cilët jetojnë në brezin kufitar doganor; Regjimin special për importin dhe eksportin e kryer nga ana e ndërmarrjeve dhe të personave të tjerë juridik.

⁷ Kolegji "Pjetër Budi" - "E Drejta Doganore", Prishtinë, 2013,

⁸ "Sistemi Doganor", Botues Universiteti "Pjetër Budi", Prishtinë 2006, fq. 108



8. ZONA E KONTROLLUAR DOGANORE

Sipas Ligjit për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror, paragrafët 12 dhe 13 të nenit 2: “Kontrolli kufitar” nënkupton kontrollin e kryer në pikat e kalimit kufitar për të siguruar që personat, mallrat dhe mjetet e tyre të transportit janë të autorizuar të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës, apo ta lëshojnë Republikën e Kosovës. “Zona e kontrollit të kalimit të kufirit shtetëror”, nënkupton sipërfaqen e identifikuar dhe shënuar zyrtarisht, e cila rrethon pikën e kalimit kufitar.

Ndërsa sipas paragrafit 14 të nenit 4 të Kodit të Doganave dhe Akcizës: “Kontroll nga Dogana, nënkupton kryerjen e veprimeve specifike si kontrollimi i mallrave, verifikimi i autenticitetit të dokumenteve, kontrollimi i kontabilitetit dhe i të dhënave të tjera, kontrollimi i mjeteve të transportit dhe pajisjeve të qarkullimit, kontrollimi i bagazheve dhe mallrave të tjera që personat mbajnë ose bartin, kryerja e verifikimeve dhe e veprimeve të tjera të ngjashme për të siguruar respektimin e legjislacionit doganor, është e nevojshme të dispozitave tjera të zbatueshme mbi mallrat që i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore dhe vëzhgimit.

9. MBIKËQYRJA DOGANORE

Mbikëqyrja doganore definohet me ligjet e secilit shtet të pavarur. Kësisoj edhe Kodi Doganor i Kosovës në paragrafin e 13-të të nenit 4 e përkufizon kështu: “Mbikëqyrja Doganore, nënkupton veprimet e ndërmarra nga Dogana për të siguruar respektimin e legjislacionit doganor, por kur është e nevojshme edhe të dispozitave të tjera të aplikueshme mbi mallrat që i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore dhe vëzhgimit.” Mbikëqyrja doganore është institut juridik shumë i rëndësishëm, i cili ekziston në secilin sistem doganor të shteteve sovrane.⁹

Me mbikëqyrjen doganore nënkuptohen masat, të cilat i ndërmarrin organet doganore për shkak të pengimit të procedurës së palejuar dhe të paautorizuar me mallin doganor, si dhe sigurimin e njëtrajtshmërisë së saj përderisa nuk zbatohet procedura e miratuar doganore. Kjo është

⁹ Kolegji “Pjetër Budi” - “E Drejta Doganore”, Prishtinë, 2013, fq.. 78



përmbledhje e aktiviteteve të caktuara të organit doganor, të cilat duhet ta pengojnë sjelljen e caktuar të subjekteve (pronarë, shfrytëzues etj.) për manipulim me mallin doganor për zvogëlimin e tij, ndërrimin e llojit, të pasurit në dispozicion dhe aktivitete të ngjashme, para se të realizohet procedura doganore.

Nëse e zbërthejmë përkufizimin e Kodit doganor mund të konstatojmë se:

Së pari, masat e mbikëqyrjes doganore përcaktohen me legjislacionin doganor dhe me rregulla të tjera doganore, ashtu siç theksuam në fillim të shpjegimit të këtij instituti juridike. Me Kodin Doganor të Kosovës janë paraparë masat e mbikëqyrjes doganore, si dhe me udhëzimin administrativ për zbatimin e kodit të doganave dhe të akcizës. Ato masa kanë karakter të obligueshëm dhe zbatimi i tyre ka për qëllim kufizimin e përkohshëm të drejtave pronësore të personave, të cilëve iu takojnë mallrat doganore (pronar, respektivisht konsumues) me ato që disponojnë.

Kjo masë e përkohshme ka për qëllim zbatimin e instrumenteve me të cilat rregullohet qarkullimi i mallrave dhe të shërbimeve me jashtë dhe në qarkullimin ndërkombëtar rrugor, respektivisht të krijojnë kushte të domosdoshme për t'u zbatuar procedura doganore dhe të kryhet doganimi i mallrave.

Së dyti, me masat e mbikëqyrjes doganore duhet të arrihen dy qëllime themelore: Të pamundësohet veprimi i paautorizuar me mallrat doganore dhe Të sigurohet që mallrat doganore të mbeten identike për nga sasia dhe cilësia, deri në momentin e zhdoganimit të tyre, me ç'rast edhe përfundojnë masat e mbikëqyrjes doganore. Pra, primare është që operimi me mallra doganore nga pronarët, poseduesit apo përfaqësuesit e tyre të bëhet në pajtueshmëri me dispozitat juridike doganore në fuqi, kurse malli doganor ta ruaj identitetin e vet, llojin, cilësinë, sasinë, asortimanin etj. ashtu siç është futur në territorin doganor dhe ka kaluar linjën doganore përkatëse.

Me fjalë të tjera përmes aplikimit të masave të mbikëqyrjes doganore, duhet të pamundësohet që obligatorët doganorë, si dhe të gjithë personat tjerë që kanë interesa nga malli i caktuar doganor, të ndërmarrin çfarëdo veprime me të cilat do të ndikonin mbi mallrat doganore, duke iu ikur procedurave relevante doganore, me çka do ta zvogëlonin sasinë e shumës së obliguar për pagesë, poashtu edhe shmangien totale nga pagesa e detyrimeve doganore.



Së treti, nga definicioni ligjor kemi kuptuar se masat e mbikëqyrjes doganore, i zbatojnë organet kompetente doganore dhe ato kanë të bëjnë me të gjitha llojet e mallrave doganore. Organi kompetent për zbatimin në praktikë të masave të mbikëqyrjes doganore, është organi doganor në rastin konkret në Republikën e Kosovës – Dogana e Kosovës. Gjegjësisht, organet doganore kanë për obligim ta evidentojnë hyrjen e mallrave në rajonin doganor, përkatësisht daljen e tyre nga rajoni doganor dhe ta përcaktojnë gjendjen në të cilën janë në momentin e hyrjes, përkatësisht daljes së tyre.

Së katërti, nga definimi i nocionit Mbikëqyrje doganore në mënyrë strikte del konstatimi se masat e mbikëqyrjes doganore nuk kanë të bëjnë vetëm me mallrat dhe me mjetet transportuese, por edhe me personelin e mjeteve transportuese, si dhe të udhëtarëve në trafikun ndërkombëtar rrugor. Kjo do të thotë se me masat e mbikëqyrjes doganore, nënkuptohet edhe kontrollim të bagazhit personal, si dhe kontrollim të personelit të mjeteve transportuese me qëllim të konstatohet se a i kanë paraqitur sendet, të cilat i mbajnë me vete sipas rregullave aktuale, respektivisht se a bartin sende, qarkullimi ndërkombëtar i të cilave është i ndaluar dhe a fshehin sende të caktuara me qëllim t'i shmangen obligimit për pagesën e doganës dhe të taksave tjera.

Me zbatimin e masave të mbikëqyrjes doganore, gjatë importit mundësohet përcaktimi i papenguar nga ana e organeve kompetente doganore, se mallrat që hyjnë në rajonin vendor doganor, a i plotësojnë kushtet e parapara në aspekt të regjimeve restriktive të mallrave. Pastaj kushtet në aspektin e mbrojtjes shëndetësore, fitopatologjike dhe të llojeve të tjera të mbrojtjes, në aspekt të normave të kualitetit dhe të standardeve të domosdoshme të parapara për lëshimin e mallrave të importuara në tregun vendor dhe në përputhje me Ligjin për Tregti me Jashtë. Kohëzgjatja e mbikëqyrjes doganore mund të jetë më e shkurtë ose më e gjatë varësisht nga rrethanat e ndryshme. Në kushtet bashkëkohore doganimit më së shpeshti kryhet në terminalët doganore në brendi të shtetit.

Nga elaborimi i nocionit mbikëqyrje doganore, kuptojmë se mbikëqyrja doganore ngërthen në vete këto karakteristika: mbikëqyrja doganore është institut juridik i paraparë me dispozita juridike pozitive; mbikëqyrja doganore zbatohet në praktikë nga organi doganor përkatës; mbikëqyrja doganore është masë e përkohshme që e kufizon pronarin, poseduesin, apo personat



tjerë të interesuar nga malli i caktuar deri sa të zbatohet procedura e caktuar doganore; mbikëqyrja doganore aplikohet edhe ndaj personave dhe bagazhit të tyre personal;

qëllimi i aplikimit të masave të mbikëqyrjes doganore, është pengimi i veprimit të pa autorizuar me mallrat doganore dhe ruajtja e identitetit të këtyre mallrave në kuptimin e mos ndryshimit të llojit, sasisë, cilësisë etj. mbikëqyrja doganore ka edhe rëndësi për konstatimin e rregullsisë së mallrave në aspektin e plotësimit të kriterëve sanitare, shëndetësore, fitopatologjike etj.

10. LLOJET E MBIKËQYRJES DOGANORE

Në teorinë juridike doganore identifikohen shumë kriterë për caktimin e tipologjisë adekuate të mbikëqyrjes doganore. Në literaturë mund të hasen këto kriterë: Drejtimi i lëvizjes; Sipas prezencës së mallrave doganore; Sipas llojit të trafikut dhe të mjeteve transportuese; Sipas mënyrës së identifikimit dhe evidentimit të mallrave doganore; dhe Sipas sendit konkret dhe koha e mbikëqyrjes doganore.¹⁰

10.1. Sipas drejtimit të lëvizjes së mallrave doganore

Sipas drejtimit të lëvizjes së mallrave doganore, mbikëqyrja doganore mund të jetë: Mbikëqyrje doganore gjatë importit; Mbikëqyrje doganore gjatë eksportit; dhe Mbikëqyrje doganore gjatë transitit të mallrave doganore. Mbikëqyrje doganore gjatë importit - Gjatë importit, mallrat teorikisht fitojnë trajtim të mallrave doganore në momentin e kalimit të vijës doganore të mallrave, por vendosja e tyre nën mbikëqyrjen doganore faktikisht kryhet në momentin e arritjes së mallrave gjegjësisht të udhëtarëve në objektet e vendkalimit kufitar. Kohëzgjatja e mbikëqyrjes doganore mund të jetë më e shkurtër ose më e gjatë varësisht nga rrethanat e ndryshme.

Varësisht nga vendi se ku bëhet doganimi importues, mbikëqyrja doganore mund të zgjasë relativisht shkurt, nëse procedura e plotë doganore dhe doganimi do të ishin kryer në vetë doganën kufitare hyrëse. Mbikëqyrje doganore gjatë eksportit - Gjatë eksportit mbikëqyrja doganore ka disa specifika të caktuara, të cilat dalin nga specifikat e mallrave doganore



eksportuese. Mbikëqyrja doganore gjatë eksportit, fillon me paraqitjen e mallrave për doganim eksportues dhe zgjatë deri në kalimin e mallrave përmes vijës doganore kah rajoni doganor.

“Mallrat kosovare të deklaruara për eksport, përpunim të jashtëm, transit apo procedurë të magazinimit doganor i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore nga çasti i pranimi të deklaratës doganore, deri në kohën e daljes nga Kosova, ose derisa të asgjësohen, ose deklarata doganore të bëhet e pavlefshme.” (neni 63/2, i Kodit Doganor të Kosovës).

Mbikëqyrje doganore gjatë transitit të mallrave doganore - Masat e mbikëqyrjes doganore ndaj mallrave doganore në tranzitin e një rajoni doganor, fillojnë në momentin e kalimit të tyre nëpër vijën doganore gjegjësisht deri në paraqitjen dhe regjistrimin e tyre në hyrjen e objekteve të doganës dhe zgjasin deri në momentin e daljes së tyre nga rajoni doganor, respektivisht me kalimin e vijës doganore të ndonjë vendi të tretë.

10.2. Sipas prezencës së mallrave doganore

Sipas prezencës së mallrave doganore kemi: Mbikëqyrja e drejtë për së drejtë doganore, dhe Mbikëqyrja e tërthortë (indirekte) doganore. Mbikëqyrja e drejtë për drejtë doganore - Për mbikëqyrjen e drejtë për drejtë doganore bëhet fjalë atëherë kur mallrat, si dhe personeli i mjeteve transportuese në trafikun ndërkombëtar, janë drejtë për drejtë prezent dhe organet doganore i ndërmarrin aktivitetet e parapara me qëllim të identifikimit të mallrave doganore dhe i përcaktojnë karakteristikat e tyre dhe me vërjen e shenjave doganore i vërtetojnë raportet e tyre.

Mbikëqyrja e tërthortë (indirekte) doganore – Për mbikëqyrjen e tërthortë (indirekte) doganore është karakteristike ajo që organet doganore rëndësinë e aktiviteteve e vejnë mbi kontrollin: obligatorët doganorë a iu përmbahen masave të parapara, a i posedojnë dokumentet adekuate doganore, me pak fjalë a veprohet me mallrat doganore ashtu siç parashohin rregullatv juridike – doganore dhe urdhëresat e organeve kompetente doganore. Mbikëqyrja indirekte doganore ka të bëjë para se gjithash për mallrat doganore të vendosura në lloje të ndryshme të hapësirave dhe në hapësira të caktuara për vendosjen e mallrave doganore të destinuar për shitje konsinjative gjegjësisht për shitje komisionuese.



10.3. Sipas llojit të trafikut dhe të mjeteve transportuese

Sipas këtyre kriteriumeve mund të dallohen aq lloje të mbikëqyrjes doganore sa ka lloje të trafikut ndërkombëtar, si dhe varësisht nga lloji i mjeteve transportuese me të cilat transportohen mallrat doganore: trafiku tokësor (rrugor, hekurudhor); trafiku ujor (dete, liqe, lumenj) trafiku ajror.

10.4. Sipas mënyrës së identifikimit dhe evidentimit të mallrave doganore

Sipas mënyrës së identifikimit dhe evidentimit të mallrave doganore kemi: Mbikëqyrjen e pa dokumentuar doganore; dhe Mbikëqyrja e dokumentuar doganore. Mbikëqyrjen e pa dokumentuar doganore - Ka të bëjë me futjen dhe nxjerrjen e mallrave nga qarkullimi ndërkombëtar rrugor, si dhe në rastet kur doganimi definitiv i mallrave kryhet në doganat hyrëse, respektivisht në mënyrë direkte pas ndërmarrjes së masave të para të domosdoshme të mbikëqyrjes doganore dhe të kontrollit.

Pa marrë parasysh se a mund të realizohet një kontroll i caktuar, edhe në dokumente bëhet fjalë për mbikëqyrje të pa dokumentuar doganore, thjeshtë për shkak se rëndësia e mbikëqyrjes doganore nuk vendohet mbi dokumente, por mbi llojin dhe gjendjen e mallrave që futen dhe dalin nga rajoni doganor. Mbikëqyrja e dokumentuar doganore - Kemi atëherë kur rëndësia e masave të mbikëqyrjes doganore, si dhe të kontrollit doganor vendohet mbi dokumentet e mallrave doganore, të cilat i shpall një vend i caktuar ose janë të domosdoshme në bazë të konventave ndërkombëtare që vendi i ka ratifikuar.

Sipas sendit konkret dhe kohës së mbikëqyrjes doganore dallojmë:

- a) Mbikëqyrjen faktike doganore;
- b) Mbikëqyrjen e vazhduar doganore; dhe
- c) Mbikëqyrjen plotësuese doganore.



Mbikëqyrjen faktike doganore - Mbi mallrat doganore është ajo mbikëqyrje që kryhet përderisa mallrat importuese nuk doganohen dhe nuk paguhet dogana dhe shpenzimet e tjera importuese, respektivisht derisa mallrat eksportuese dhe tranzitive nuk e kalojnë vijën doganore dhe nuk e braktisin rajonin doganor të një vendi të caktuar. Ky lloj i mbikëqyrjes doganore quhet faktik për shkak se mallrat doganore përnjëmend gjenden nën kontrollin e organeve doganore, deri në mbarimin efektiv të procedurës doganore.

Mbikëqyrjen e vazhduar doganore - Ky lloj i mbikëqyrjes doganore zbatohet në rastet kur një mall i caktuar doganor, është i çliruar nga mbikëqyrja doganore në bazë të së drejtës për çlirim nga pagesa e doganës dhe të shpenzimeve të tjera eksportuese, që i ka shfrytëzuar një obligator i caktuar doganor (ndërmarrje, person juridik, organizatë ose person fizik) e pastaj me sendin e liruar nga dogana, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me bazën mbi të cilën e ka shfrytëzuar përparësinë.

Këto janë rastet kur një obligator i caktuar doganor, është çliruar nga pagesa e doganës. Nëse konstatohet se shfrytëzuesi mallin e shfrytëzon për qëllime të tjera të ndryshme, nga ato për të cilat është i liruar nga pagesa e doganës dhe të shpenzimeve të tjera, ose mallrat i ka tjetërsuar para skadimit të afatit të caktuar, dogana kompetente mund të iniciojë procedurë për detyrimin e shfrytëzuesit për ta paguar doganën dhe shpenzimet e tjera dhe eventualisht të ndërmarr masa të tjera.

Mbikëqyrja plotësuese doganore - Mbikëqyrja plotësuese (posteriore) doganore paraqitet në rastet kur mallra të caktuara doganore, që janë të doganuara dhe për të cilat është paguar doganë, ose që janë të liruara nga mbikëqyrja doganore, përsëri futen nën mbikëqyrjen doganore për shkak të diturive të reja eventuale në lidhje me instrumentet e përdorura në procedurën doganore, ose të diturive për llojin e mallit për shkak të cilit ka ardhur deri të llogaritja dhe pagesa e shumës më të madhe ose më të vogël të doganës dhe të shpenzimeve të tjera importuese.



11. MALLRAT DOGANORE

Malli doganore është institucioni pothuaj më i rëndësishëm i të drejtës dhe sistemit doganor. Ekzistimi i tregtisë ndërkombëtare presupozon krijimin e sistemeve doganore, ashtu siç kemi theksuar në fillim të shtjellimi tonë. Shumica veprimeve, të cilat i ndërmarrin subjektet e së drejtës doganore janë të drejtuara kah malli doganor. Ekzistimi ose mosekzistimi i tyre në masë të madhe e përcakton fatin e ekzistimit të së drejtës doganore, gjegjësisht të sistemit doganor në tërësi. Malli doganor është *condicie sine qua non* (kusht i domosdoshëm) për të drejtën dhe sistemin doganor.

Përkufizimi i mallit doganor dallon nga përkufizimi i mallrave në përgjithësi. Nga jeta e përditshme e dimë se mallrat janë gjësende, të cilat kanë vlerë, sasi, cilësi, masë, dhe vëllim të caktuar. Në këtë aspekt definimi i mallrave si gjësende bëhet nga dy këndvështrime: përkufizimi juridik i mallrave dhe përkufizimi ekonomik. Nga aspekti ekonomik mallrat janë të mira materiale, të cilat plotësojnë një nevojë shoqërore të individit. Sendet në kuptimin juridik janë pjesë materiale të natyrës, të cilat gjenden në pushtetin e njeriut mbi të cilat krijohet e drejta e pronësisë apo ndonjë e drejtë tjetër subjektive. Do të thotë se sendet janë objekte materiale dhe më i rëndësishëm i marrëdhënieve juridike – civile për arsyes se e drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera reale i kanë për objekt të tyre të drejtpërdrejtë sendet. Duke e përkufizuar nocionin e sendeve, studiuesi i njohur i së drejtës, Vedrish shkruan se: “me sende në kuptimin juridik – civil nënkuptojmë pjesët materiale të natyrës, të cilat mund të vërehen me shqisa, të cilat janë të kufizuara në hapësirë dhe të cilat ekzistojnë tani, ose ekziston supozimi se me siguri do të paraqiten në të ardhmen”.

Nocionin për sendet zakonisht caktohet me ligj apo me Kod Civil. Kuptimi juridik dhe ekonomik i sendit e determinon edhe kuptimin mallit doganor. Shikuar nga ky aspekt edhe malli doganor duhet t’i plotësoj kushtet e lartpërmendura të sendit, sipas kuptimit që i jep e Drejta Sendore dhe ligjet pozitive që e rregullojnë të drejtën sendore. Mirëpo duhet pasur parasysh se malli doganor, edhe pse duhet t’i plotësoj kushtet e përmendura, ai vetvetiu nuk është mall doganor, por duhet t’i nënshtrohet regjimit juridik të së drejtës doganore për tu konsideruar mall doganor. Pra, jo secili send është mall doganor, por që mund të jetë secili send mall doganor kjo nuk vihet në dyshim.



Shikuar nga ky aspekt mall doganor është vetëm ai mall, i cili është në qarkullim juridik ndërkombëtar,

i cili importohet apo kalon linjën doganore të territorit doganor të shtetit përkatës, përkatësisht eksportohet apo është i dedikuar për një vend të tretë dhe kalon nëpër territorin doganor të një shteti të caktuar, i cili ka vlerë përdoruese dhe ndaj të cilit ligji parasheh vendosjen e masave të mbikëqyrjes doganore dhe të doganim - zhdoganim.

Natyrisht se subjektet në afarizmin tregtar ndërkombëtar zhvillojnë aktivitet të vetëdijshëm njerëzor, me çka nënkuptohet se me aktivitet të vetëdijshëm dhe ligjor kalon linjën doganore të një territori doganor, në territorin tjetër doganor. Nga nocioni kuptojmë se mall doganor mund të jetë vetëm sendi i tundshëm. “Sendet e luajtshme janë objektet trupore të pavarura, që nuk janë në mënyrë të përhershme të lidhura me tokën ose pjesët e tokës dhe që në përgjithësi mund të lëvizin”. Në vijim do të shtjellojmë karakteristikat e mallit doganor.

12. KARAKTERISTIKAT E MALLIT DOGANOR

Më qëllim të kuptimit sa më të mirë, këtij instituti juridik shumë të rëndësishëm për të drejtën dhe sistemin doganor, do t’i analizojmë shkurtimisht disa karakteristika apo veçori të mallrave doganore, të cilat në një mënyrë apo tjetrën janë përfshirë në përkufizimin e nocionit mall doganor, e ato janë: malli doganor duhet t’i plotësoj kriteret juridike të parapara me dispozita juridike të së drejtës sendore doganore; malli doganor duhet t’i plotësoj kriteret juridike të parapara me legjislacionin doganor; mall doganor është ai mall, i cili është i dedikuar për qarkullimin ndërkombëtar; mall doganor mund të jetë vetëm sendi i luajtshëm; malli doganor përbënë objekt të qarkullimit ndërkombëtar të vetëdijshëm njerëzor; ndaj mallit doganor vendosen masat e mbikëqyrjes dhe kontrollit doganor; malli doganor duhet të ketë vlerë përdoruese; dhe vlera e mallit si kriter për caktimin e detyrimeve doganore. Në këtë pjesë do ti shtjellojmë vetëm dy veçoritë e fundit, sepse të tjerat janë trajtuar mjaftueshëm më lartë.

Malli doganor duhet të ketë vlerë përdoruese – kuptohet si veti dhe cilësi e prodhimit të caktuar nga aktiviteti njerëzor i dedikuar për treg, i cili plotëson një nevojë të caktuar shoqërore dhe publike, (konsumim, investim riprodhues ose personal).



Nëse një mall nuk ka vlerë përdorimi, atëherë nuk mund të ketë as vlerë qarkullimi, prandaj nuk mund të jetë lëndë e shkëmbimit tregtar ndërkombëtar.

Vetëm mallrat që kanë veti dhe cilësi ekonomike, mund të tregtohen dhe marrin statusin e mallit doganor.

Nga praktika juridike, kemi raste kur shkëmbimi i caktuar ndërkombëtar nuk mund të quhet mall doganor, p.sh. transportimi i kufomave apo pjesëve të trupit të njeriut të vdekur, i cili transportohet për kryerjen e ceremonive të varrimit nuk konsiderohet mall doganor, edhe pse ndaj këtij shkëmbimi vendosen masat e mbikëqyrjes doganore. Duke e ditur se njeriu i vdekur nuk ka vlerë përdoruese dhe se ai transportohet vetëm për varrosje në vendin e vet, ai nuk përbën mall doganor dhe nuk kryhet procedura e doganimit. Mirëpo në rast se transportohen pjesë të ndryshme të trupit me qëllim të amputimit apo të transplantimit, atëherë kryhen të gjitha procedurat doganore relevante dhe mallrat e tilla konsiderohen mallra doganore. Pjesët për transplantim kanë vlerë përdoruese dhe për këtë arsye zbatohen dispozitat juridike doganore për mallrat doganore.

Vlera e mallit si kriter për caktimin e detyrimeve doganore – vlera e mallit ka rëndësi të madhe për caktimin e detyrimeve doganore me rastin e zhdoganimit të mallit përkatës. Ky kriter ka rëndësi sidomos kur aplikohen taksat doganore sipas vlerës. Taksat doganore sipas vlerës përdoren pothuaj në secilin sistem doganor të botës. Në rast të aplikimit të taksave doganore specifike, atëherë vlera e mallrave nuk ka ndonjë rëndësi të madhe, por siç thamë më lart taksat doganore, sipas vlerës së mallrave, përdoren më së shumti në praktikën bashkëkohore të sistemeve doganore, ose si të vetme ose në bashkëveprim me llojet tjera të taksave doganore, për këtë edhe ka rëndësi të madhe vlera për mallrat doganore.

Sipas nenit 33 të Kodit doganor të Republikës së Kosovës “Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës.



13. KONKLUZIONET

Institucionet doganore përbëjnë një shtyllë themelore të sistemit juridik dhe ekonomik të shtetit, pasi sigurojnë zbatimin e politikave tregtare, fiskale dhe mbrojtjen e interesave kombëtare.

1. Funksonimi efikas i administrates doganore ndikon drejtpërdrejt në të ardhurat buxhetore, në lehtësimin e tregtisë dhe në luftimin e kontrabandës dhe evazionit fiskal.
2. Kuadri ligjor doganor është në proces të vazhdueshëm përshtatjeje me standardet ndërkombëtare dhe me rregullat e Bashkimit Evropian veçanërisht në aspektin e harmonizimit të procedurave dhe transparencës.
3. Bashkëpunimi nderinstitucional ndërmjet doganës, policisë, administrates tatimore dhe institucioneve të tjera shtetërore është faktor kyç për sigurimin e një sistemi të integruar dhe efikas të kontrollit kufitar.
4. Modernizimi dhe digjitalizimi i procedurave doganore kanë ndikuar në rritjen e efikasitetit, në uljen e korrupsionit dhe në lehtësimin e qarkullimit të mallrave dhe kapitalit.
5. Megjithatë janë bërë përpjekje të dukshme, sfida të tilla si mungesa e burimeve njerezore të kualifikuara, procedurat e nderlikuara dhe vonesat administrative ende ndikojnë në funksionimin optimal të institucioneve doganore.
6. Edukimi profesional dhe trajnimi i vazhdueshëm i nepunësve doganorë është thelbësor për zbatimin korrekt të legjislacionit dhe për ruajtjen e integritetit institucional.
7. Në tërësi, institucionet juridike doganore kontribuojnë në forcimin e shtetit ligjor, në nxitjen e tregtisë së ndershme dhe në garantimin e sigurisë ekonomike e kufitare të shtetit.



14. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Ky punim na lë të kuptojmë se Institucionet Doganore të një shteti luajnë rol tejet të rëndësishëm madh në ekonominë e një shteti duke mbrojtur doganën, produktet vendore si dhe duke nxitë investitorët e huaj dhe duke i bindur ata për sigurinë ekonomike në atë shtet.

Po ashtu studiuam edhe për burimet juridike të një sistemi doganor me anë të të cilit mbrohet sistemi doganor si dhe rregullohen të gjitha procedurat administrative doganore për një lëndë doganore ku siç shihet edhe në punim, që një lëndë doganore të zhdoganohet duhet ti nënshtrohet disa procedurave doganore të cilat janë të cekura pikërisht në këto burime juridike në mënyrë që ai mall të zhdoganohet në mënyrë të drejtë dhe sipas ligjit.

Po ashtu studiuam për mallin doganor dhe vlerën e tij. Mall doganor quajmë mallin i cili është komercial si dhe i nënshtrohet të gjitha procedurave doganore gjatë kalimit prej një shteti në shtetin tjetër, për përcaktimin e vlerës së tij në mënyrë që malli ti ik dampingut doganor ekzistojnë metoda të ndryshme të cekura në punim.

Rekomandime që dalin në lidhje me Institucionet Juridike Doganore

1. Forcimi i kapaciteteve profesionale të institucioneve doganore

Rekomandohet investimi në trajnime të vazhdueshme për personelin doganor, sidomos në fushat e teknologjisë, kontrollit fizik dhe analizës së riskut për të rritur efikasitetin dhe ulur gabimet në procedurat doganore.

2. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies

Institucionet doganore duhet të krijojnë mekanizma të hapur informimi për qytetarët dhe bizneset, duke publikuar rregullore, tarifa, procedura dhe afatet e shërbimeve për të reduktuar mundësitë për korrupsion dhe abuzime.

3. Digjitalizimi i shërbimeve dhe procedurave doganore

Rekomandohet zëvendësimi i proceseve manuale me sisteme elektronike si deklarimi online, menaxhimi i riskut dhe shkëmbimi elektronik i të dhënave, duke ulur kohën e zhdoganimit dhe rritur sigurinë.



4. Bashkëpunimi ndërinstitucional

Dogana duhet të forcojë bashkëpunimin me policinë, administratën tatimore, autoritetet e sigurisë ushqimore dhe institucionet ndërkombëtare për të luftuar kontrabandën, pastrimin e parave dhe tregtinë e paligjshme.

5. Harmonizimi i legjislacionit doganor me standardet ndërkombëtare

Është e domosdoshme që ligjet dhe rregulloret doganore të jenë në përputhje me konventat e BE-së, OBT-së dhe Organizatës Botërore të Doganave, në mënyrë që shteti të lehtësojë tregtinë dhe të sigurojë konkurrueshmëri.

6. Zhvillimi i një sistemi efektiv të menaxhimit të riskut

Institucionet juridike doganore duhet të zbatojnë metoda moderne të analizës së riskut për të identifikuar mallrat dhe subjektet me risk të lartë, duke mundësuar kontrolle më të synuara dhe efikase.

7. Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe teknologjike në pikat kufitare

Investimi në pajisje skanuese, laboratorë doganorë, hapësira magazinimi dhe zona kontrolli rrit sigurinë dhe e bën më të shpejtë procesin e qarkullimit të mallrave.



15. LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Artikulli: How relevant Is customs in the operation of free trade areas? Shqyrton rolin e doganave në zonat e tregtisë së lirë.
2. Bibloteka e Kolegjit Pjetër Budi – Libra të ndryshme lidhur me analizat dhe rezultatet e bëra për drejtimin e doganave.
3. Burime të tjera të siguruara fizikisht nga dokumente dhe të dhënat të tjera lidhur me temen e punuarë.
4. Dogana e Kosovës - <https://dogana.rks-gov.net/>
5. Dokumenti Ligjor: Customs and excise code of the Republic of Kosovo (08/L-247) per kuadrin ligjor doganor në Kosovë.
6. Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës –
7. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>
8. Kolegji “Pjetër Budi” - “E Drejta Doganore” , Prishtinë, 2013
9. Libri - “Sistemi Doganor” , Manastir, 2006.
10. Libri: Capacities of Kosovo institutions for implementation of legislation – Sadete Demaj- Kajtazi, për kapacitetet institucionale në Kosovë për zbatimin e ligjit, që mund të jetë relevant për institucionet doganore.
11. Udhezuesi: Customs Law Research Guide nga Georgetown Law Library – per burime te metejshme nderkombetare dhe ligjore.
12. Wikipedia - https://sq.wikipedia.org/wiki/Teoria_juridike
13. World customs journal – reviste dy vjecare me studime te ndryshme per doganat, lehtesimin e tregtisë, kontrollin kufitar.
14. Ylber Rraci, “Sistemi doganor në Kosovë” , Prishtinë, mars 2003.